



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.427/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevc, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të ndarjes së vendeve të garantuara për Kuvendin e Republikës së Kosovës për komunitetin Rom, Ashali dhe Egjiptian, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 09.11.2019, mori këtë:

VENDIM

Hudhet i palejuar apeli Anr.427/2019 i datës 07.11.2019, i paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj, kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të ndarjes së vendeve të garantuara për Kuvendin e Republikës së Kosovës për komunitetin Rom, Ashali dhe Egjiptian.

Arsyetim

Me datë 07.11.2019 në ora 14:20, subjekti politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.427/2019, me të cilën pretendon se pas shpalljes së rezultatit zyrtar të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nga KQZ, rezultat ky i cili për subjektin në fjalë është i papranueshëm, pasi që sipas tyre janë dëmtuar me mos përfaqësim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Më tutje parashtuesi i apelit pretendon se subjekti i tyre, beson bindshëm se kanë fituar një ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës sipas nenit 64 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse subjekti ynë ka më shumë vota se dy partitë tjera të komunitetit rom: PRBK-së, KNRP si dhe të komunitetit Egjiptian IRDK dhe si e tillë renditet si forcë e tretë politike brenda këtyre tri komuniteteve të cilët garojnë për katër vendet e garantuara për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe vendi i katërt shtesë i takon subjektit tonë, duke u bazuar në nenin 111.2 pika b dhe c të LPZ-së. Me tutje në apel theksohet se në procesin e këtyre zgjedhjeve ka pasur parregullësi pasi që në formularët e rezultateve në shumicën e rasteve votat e PDK-së u janë përshkruar PLE-së dhe PAI-së, pasi që kanë qenë të radhitura njëra pas tjetrës dhe rubrika për

rezultat i ka munguar PLE-së, andaj këto dy subjekte kanë pasur rritje drastike gjë e cila e ka rrezikuar hyrjen e PDAK-së, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të subjektit politik PDAK të parashtruara ndaj vendimit të KQZ-së, lidhur me shpërndarjen e vendeve në parlament të Kosovës, janë të palejuara që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f.

Për me tepër në nenin 63.6 të LZP-së, është paraparë që vendimi i KQZ-së nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qarte me këtë ligj. Nga kjo rezulton se, si përjashtim nga ajo çka parashihet në këtë dispozitë juridike është neni 122 par. 1 i LZP-së, ku taksativisht janë paraparë çështjet për të cilat vendimi i KQZ-së, mund të ankimohet, në mesin e të cilave nuk qëndron edhe çështja e caktimit nga ana e KQZ-së, për shpërndarjen e ulëseve të subjekteve politike në Kuvend. Meqenëse në asnjërën nga pikat e lartpërmendura të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në ankesë, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 427/2019 më datën 09.11.2019

**Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.